

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6270  
E hënë, 22 mars 2021  
çmimi 0.40 €

## Fillon konstituimi i institucioneve të reja

FAQE 3



Sot (e hënë) mbahet seanca konstituive e legjislaturës së tetë të Kuvendit

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INTERVISTË ME DIPLOMATIN AMERIKAN JAMES RUBIN ■ FAQE 4-5



# BIDEN DHE BLINKEN, FAT I MIRË PËR KOSOVËN

James Rubin, ndihmëssekretari i Shtetit në administratën e Bill Klintonit, diplomati amerikan që ishte ndër protagonistët kryesorë për arritjen e Marrëveshjes së Rambujesë, në një intervistë për "Demokracia.com" ka shprehur krenari për ndihmën amerikane dhënë për popullin e Kosovës në kohën kur ai ishte pjesë e Departamentit të Shtetit Amerikan. Diplomati që përshkruhet edhe si

ish-krahu i djathtë i sekretares Madeleine Albright, e quan fat të mirë për Kosovën që tani në Shtëpinë e Bardhë është një president dhe një sekretar i Shtetit, që Ballkanin e kanë një nga çastet përcaktuese të angazhimit të tyre në politikën e jashtme, ku lidhshipi amerikan ishte vendimtar dhe kur viktimat ishin ndihmuar dhe agresori ishte sanksionuar. Ish-zëdhënësi i Departamentit të

Shtetit Amerikan për "Demokracia.com" thotë se për sa kohë që populli dhe liderët e Kosovës u qëndrojnë prapa parimeve demokratike dhe të tolerancës, parime këto që e kanë bërë Perëndimin të intervenojë, nuk ka arsye që Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti i Shtetit të mos e shohin Kosovën vend mik dhe vend me të cilin vazhdojnë të jenë krenarë që e kanë ndihmuar

## LDK-ja ZGJEDH KRYESINË E RE, FILLOJNË PAKËNAQËSITË

FAQE 3



## 500 PUNËTORË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS MORËN VAKSINËN KUNDËR COVIDIT NË SHQIPËRI

FAQE 7

## OPINION

### QEVERIA DHE INSTITUCIONET E REJA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, DISA PRIORITETE DHE SFIDA F. 8

Burim BREZNICA

## AKTUALE



### DIPLOMATI AMERIKAN JAMES RUBIN: THAÇI ËSHTË NJERI QË E MBAN FJALËN F. 3

### TETË TË VDEKUR DHE 793 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

## EKONOMI

### NË FONDIN PËR MENAXHIMIN E COVID-19 U GRUMBULLUAN 716 MIJË EURO F. 9

### OEK-u KËRKON ZBATIMIN E LIGJIT PËR RIMËKËMBJE DHE FALJEN E GJOBAVE F. 9



## SPORT

### BALLKANI SHFRYTËZON GABIMIN E DRITËS, MERR KRYESIMIN NË SUPERLIGË F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# LDK-ja zgjedh kryesinë e re, fillojnë pakënaqësitë

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINE, 21 MARS - Lutfi Haziri, Gazmend Muaxheri, Anton Quni dhe Shqipe Mjekiçi janë nënkryetarët e rinj të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Kështu është vendosur në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, në të cilën është zgjedhur edhe kryesia e re e partisë, në përbërje të së cilës janë 33 anëtarë. Sekretar i LDK-së është zgjedhur Imri Ahmeti. Në kryesinë e re nuk janë përfshirë Agim Veliu, Haki Rugova, Ismet Beqiri, Arban Abrashi dhe Florian Dushi. Pas zgjedhjes së kryesisë së re të LDK-së kanë filluar edhe pakënaqësitë brenda kësaj partie. Naser Rugova ka thënë se LDK-ja asnjëherë nuk ka pasur kryesi më të dobët se kjo. "Kryesi më të dobët LDK-ja nuk ka pasur kurrë. Reciklim i partisë Ora, distancim nga presidenti Rugova, tentim transformim i partisë në servis

të 'Rinvest-it', ka shkruar Rugova në llogarinë e vet në "Facebook".

Rugova ka parashtruar edhe pyetje për kryetarin e ri të LDK-së, Lumir Abdixhikun. "Pse kjo formulë e dështuar politike duhet të riciklohet në majat e LDK-së, si parti tradicionale dhe themeltare e shtetit të Kosovës? Çka është ky eksperiment me LDK-në që po e bën kryetari i ri? Ku duam të shkojmë kështu?", ka shkruar Rugova.

Ndërkaq Melihate Tërmmkollit, ish-deputete dhe ministre e kësaj partie, ka thënë se me rënien e LDK-së në duar të "Soros-istëve", "Ora-istëve", "Riinvest-ëve", ra e djathta kombëtare në Kosovë.

Ndaj sjelljes së liderit të ri të LDK-së ka reaguar edhe deputeti i zgjedhur, aktualisht zëvendëskryeministër në detyrë, Driton Selmanaj. Ky i fundit ka kritikuar Abdixhikun rreth paralajmërimit që ka bërë për takim me Vjosa Osmanin. Selmanaj ka shkruar në



llogarinë e vet në "Facebook" se 'turri dhe vrap' për ta takuar Vjosa Osmanin nuk është asgjë tjetër pos turr për ta rrëzuar edhe më shumë LDK-në. "Çdo përpjekje për ta ndarë apo diferencuar Vjosën nga Albini dhe Vetëvendosja, është përpjekje për ta transferuar mashtrueshëm votën te projekti i këtij binomi të dëmshëm politik. 'Turri dhe vrap' për ta takuar Vjosën nuk është asgjë tjetër pos turr për ta rrëzuar edhe më shumë LDK-në dhe dinjitetin e 110 mijë

votuesve qëndrestarë të saj", ka shkruar Selmanaj. Por ky reagim i Selmanajt nuk i ka pëlqyer nënkryetarit të ri të LDK-së, Anton Qunit, i cili edhe ka reaguar. "Lumiri ishte i fundit nga liderët e partive që takoi znj. Osmani në konsultim gjithëpërfshirës me strukturat e LDK-së. Nuk kishte as 'turr' e as 'vrap'! LDK-së po i rikthehet dinjiteti me hapa shumë të sigurt. 'Dream Team' në krye me Lumirin", ka shkruar Quni në llogarinë e vet në vet "Facebook".

## Kryesia e re e LDK-së

**Kryetar:**  
1. Lumir Abdixhiku

**Nënkryetar:**  
2. Lutfi Haziri  
3. Gazmend Muhaxheri  
4. Anton Quni  
5. Shqipe Mjekiçi

**Sekretar:**  
6. Imri Ahmeti

**Anëtarët e tjerë:**  
7. Kujtim Shala  
8. Avdullah Hoti  
9. Hykmete Bajrami  
10. Arben Gashi  
11. Armend Zemaj  
12. Sibel Halimi  
13. Doruntinë Maloku  
14. Dr. Ekrem Hyseni  
15. Dr. Ardian Shala  
16. Xhafer Tahiri  
17. Dr. Alban Zogaj  
18. Vlora Dumoshi  
19. Safet Kamberi  
20. Brikenda Kryeziu  
21. Fadil Krasniqi  
22. Sokol Haliti  
23. Teuta Sahatqija  
24. Dr. Valon Murtezi  
25. Besian Mustafa  
26. Dr. Lutfi Zharku  
27. Dr. Muhamet Hamiti  
28. Dr. Faton Bislimi  
29. Rrezarta Krasniqi  
30. Ilir Ferati  
31. Besa Gaxherri  
32. Lirije Kajtazi  
33. Fidan Rekaliku

## Merkeli do ta kërkojë zgjatjen e masave kundër pandemisë



BERLIN, 21 MARS - Kancelarja gjermane Angela Merkel po kërkon t'i zgjasë kufizimet për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit deri në muajin prill, raporton AFP, duke cituar një dokument qeveritar. Diskutimet e kancelares Merkel me udhëheqësit e landeve do të zhvillohen të hënën (22 mars). Gjermania

po përballet me një rritje të numrit të të infektuarve me koronavirus. Agjencia DPA raporton se për shkak të kësaj situatë, qeveria mund të marrë masa shtesë të izolimit. Gjatë javës së kaluar numri i të infektuarve për 100 000 banorë për të gjithë Gjermaninë është rritur në 103.9, tha të dielën Instituti për Sëmundje

Infektive "Robert Koch" (RKI). Tejkalimi i shifrës 100 shpesh do të thotë se rregullat kundër pandemisë duhet të fuqizohen. Për shembull, të premtën autoritetet në qytetin e Hamburgut shtrënguan masat e kontrollit pasi niveli shtatëditësh u rrit mbi 100. Tani ky rajon është në një bllokim shumë më të ashpër.

## Bullgaria i bën thirrje Rusisë ta ndalë fushatën e spiunimit

SOFJE, 21 MARS - Kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, i bëri thirrje Rusisë ta ndalë fushatën e spiunimit ndaj vendit të tij. Deklarata u bë një ditë pasi autoritetet bullgare shkatërruan një grup spiunimi që i dërgonte sekrete ushtarake Rusisë. Bullgaria është vend anëtar i NATO-s

dhe Bashkimit Evropian. Prokurorët bullgarë kanë akuzuar gjashtë persona, përfshirë ish-oficerë të inteligjencës ushtarake dhe të tanishme, për dërgimin e informacionit të klasifikuar në lidhje me Bullgarinë, NATO-n dhe Bashkimin Evropian në Ambasadën Ruse në Sofje.

Nën akuzat e spiunimit, që nga tetori i vitit 2019 Bullgaria ka dëbuar pesë diplomatë dhe punonjës të Ambasadës Ruse. "Mund të lind nevoja që prapë të deklarojmë si të padëshiruar diplomatët rusë. Unë u bëj thirrje përsëri udhëheqësve të tyre ta ndalojnë spiunimin në

Bullgari. Miqësia është miqësi, por partneriteti ynë euro-atlantik është një faktor i pashmangshëm", ka thënë ai. Ambasadën e Rusisë në Bullgari mohoi pretendimet e spiunimit. Zyrtarët rusë thanë se kjo është një përpjekje për ta dëmtuar dialogun ruso-bullgar.



## ShBA-ja dënon një maqedonas dhe një rus për krime kibernetike

UASHINGTON, 21 MARS - Nën akuzat për përfshirje në krime kibernetike të nivelit ndërkombëtar, Shtetet e

Bashkuara kanë dënuar me burgim një rus dhe një maqedonas. Rrjeti në të cilin ishin të përfshirë këta dy

persona është përgjegjës për vjedhjen e 568 milionë dollarëve në të gjithë botën, ka njoftuar Departamenti i Drejtësisë në

ShBA. Sergei Medvedev, 33 vjeç, nga Rusia dhe Marko Leopard, 31 vjeç, nga Maqedonia e Veriut, u dënuan me 10 vjet,

përkatesisht me pesë vjet burgim. Më parë ata ishin deklaruar fajtorë nën akuzën e konspiracionit mashtrues.

SOT (E HËNË) MBAHET SEANCA KONSTITUIVE E LEGJISLATURËS SË TETË TË KUVENDIT

# Fillon konstituimi i institucioneve të reja

Seanca konstituive e legjislaturës së tetë e Kuvendit, e cila do të mbahet sot (e hënë), do ta shënojë fillimin e konstituimit të institucioneve të reja. Pas zgjedhjes së kryetarit të ri të Kuvendit dhe nënkryetarëve, pritet që shumë shpejt të formohet edhe qeveria e re, meqenëse Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve ka bërë me dije se i ka votat e nevojshme. Konstituimi i Kuvendit dhe zgjedhja e qeverisë së re mund të mos sjellin stabilitet institucional në rast se Kuvendi dështon ta zgjedhë presidentin e ri të vendit

**EPOKA ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 MARS - Sot (e hënë) do të mbahet seanca konstituive e legjislaturës së tetë e Kuvendit të Kosovës, me fillim nga ora 10:00. Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit, ka bërë me dije se i ka siguruar votat e nevojshme për ta konstituuar Kuvendin dhe formuar qeverinë e re. Seanca do të kryesohet nga deputeti më i vjetër në moshë, Avni Dehari (LV), i shoqëruar nga deputetja më e re në këtë legjislaturë, Adelina Grainca (PDK).

Pikë e parë e seancës do të jetë formimi i komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve,

për t'u pasuar me betimin e deputetëve.

Posti i kryetarit të Kuvendit, sipas Kushtetutës, i takon partisë më të madhe.

LV-ja ka treguar se nënkryetari i kësaj partie, Glauk Konjufca, do të jetë kandidat për kryetar të institucionit më të lartë në vend.

Deri më tani vetëm LDK-ja ka treguar se kandidat për nënkryetar të Kuvendit nga kjo parti do të jetë Kujtim Shala. Seanca konstituive do të përmbyllet me zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.

Nuk dihet ende kur do të votohet qeveria e re. Zyrtarët e LV-së kanë thënë se kjo do të ndodhë së shpejti.

Në takimet konsultative që javën e kaluar kanë pasur lideri

i LV-së, Albin Kurti dhe Vjosa Osmani, me përfaqësuesit e partive politike, kanë treguar se i kanë siguruar votat e komuniteteve joserbe për qeverinë e re. Pas këtyre takimeve, LV-ja ka lëshuar një komunikatë për media, ku ka treguar për kërkesat e Kurtit dhe Osmanit ndaj partive të tjera. "Në këtë kontekst, të dy kandidatët u kanë ofruar subjekteve politike bashkëpunim për çështje të interesit nacional. Ata kanë kërkuar konstruktivitet të subjekteve politike nëpërmjet pranisë në të tri seancat e zgjedhjes në të tri institucionet kryesore të shtetit. Në përmbyllje të takimeve, Kurti dhe Osmani kanë shfaqur optimizmin që ky proces të përmbyllet me sukses dhe në përputhje me vullnetin qytetar të shprehur në zgjedhjet e 14 shkurtit", është thënë në komunikatën e LV-së.

Në mbledhjen e kryesisë së vjetër të Kuvendit, e cila është mbajtur javën e kaluar, janë përcaktuar edhe ulëset për grupet parlamentare. Kështu, konform rregullores dhe praktikës së deritashme, grupi më i madh parlamentar (Vetëvendosje) do të ulet në qendër, grupi i dytë me radhë (PDK), në anën e djathtë të kryesuesit të seancës, ndërsa grupi i tretë (LDK), në anën e majtë të kryesuesit. Përcaktimi i ulëseve për grupet e tjera do të

bëhet gjatë ditëve në vijim.

Në zgjedhjet e 14 shkurtit LV-ja ka marrë 50.2 për qind të votave apo 58 deputetë, PDK-ja 17 për qind apo 19 deputetë, LDK-ja 12.7 për qind apo 15 deputetë, AAK-ja 7.1 për qind apo 8 deputetë, ndërsa 20 deputetë do të jenë nga minoritetet.

## Zgjedhja e presidentit, sfidë kryesore

Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se pas konstituimit të Kuvendit do të ndodhë formimi i qeverisë së re, ndonëse kjo procedurë është kontestuar nga disa juristë. Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka bërë me dije se kjo legjislaturë fillimisht duhet ta zgjedhë presidentin e ri e më pas qeverinë. "Renditja e organeve kushtetuese në demokraci parlamentare çfarë është Kosova vetë për vete flet për rëndësinë e tyre. Zgjedhja e Kuvendit pasohet nga presidenti, qeveria dhe organe të tjera. Kjo është kështu pa përjashtim në demokracitë kushtetuese parlamentare", ka thënë Hasani. Sipas tij, udhëtuesi i detyrës i presidentit nuk mund ta propozojë kandidatin për kryeministër.

Por, juristë të tjerë kanë vlerësuar se Kushtetuta nuk parasheh se cili institucion duhet të zgjedhet i pari, duke


treguar se më herët ka ndodhur që ushtruesi i detyrës të presidentit ta propozojë mandatarin për kryeministër. Pavarësisht këtyre mendimeve, konstituimi i Kuvendit dhe zgjedhja e qeverisë së re mund të mos sjellin stabilitet institucional në rast se Kuvendi dështon ta zgjedhë presidentin e ri të vendit. Deri më tash, Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit, nuk ka marrë përkrahjen nga asnjëra prej partive shqiptare në Kuvend, se do të marrin pjesë në procesin e votimit të kandidatit të tyre, Vjosa Osmani, për mandat pesëvjeçar presidencial. Pa pjesëmarrjen në votim të deputetëve të partive shqiptare, LV-ja e ka të pamundur ta zgjedhë presidentin.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se kjo parti nuk do ta përkrahë kandidaturën e Osmanit për presidente. "Qëndrimi i PDK-së është super i qartë. Ne nuk e mbështesim kandidaturën e saj, nuk votojmë për të, nuk marrim pjesë në votim. Prandaj çështjet e tilla të qëndrimeve në sallë mendoj se janë tema të natyrës teknike", ka deklaruar Hoxhaj.

Edhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se opozita nuk e ka përgjegjësinë që t'i sigurojë dy të tretat e votave për zgjedhjen e presidentit të ri.

Kurse kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka paralajmëruar takim të ri për kandidaturën e Osmanit për presidente. "Jemi pajtuar që pas formimit të institucioneve, të takohemi me pretendentin për candidate për presidente dhe ta kuptojmë më qartë pozicionin e saj si pretendente për presidente karshi LDK-së, LV-së, karshi partive opozitare, në veçanti karshi nismës së saj politike të paralajmëruar. Pas formimit të institucioneve javën tjetër, presim ftesën nga pretendentja për presidente", ka thënë Abdixhiku, pas takimit të parë konsultativ me Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin.

Pozita e presidentit ka mbetur me ushtrues detyre qysh më 5 nëntor, pas dorëheqjes të Hashim Thaçit nga posti i presidentit, për t'u përballur me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të ngritura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të Dhomave të Specializuara me seli në Hagë.





INTERVISTË ME DIPLOMATIN AMERIKAN JAMES RUBIN

# Biden dhe Blinken, fat i mirë për Kosovën

James Rubin, ndihmëssekretari i Shtetit në administratën e Bill Klintonit, diplomati amerikan që ishte ndër protagonistët kryesorë për arritjen e Marrëveshjes së Rambujesë, në një intervistë për “Demokracia.com” ka shprehur krenari për ndihmën amerikane dhënë për popullin e Kosovës në kohën kur ai ishte pjesë e Departamentit të Shtetit Amerikan. Diplomati që përshkruhet edhe si ish-krahu i djathtë i sekretares Madeleine Albright, e quan fat të mirë për Kosovën që tani në Shtëpinë e Bardhë është një president dhe një sekretar i Shtetit, që Ballkanin e kanë një nga çastet përcaktuese të angazhimit të tyre në politikën e jashtme, ku lidhshipi amerikan ishte vendimtar dhe kur viktimat ishin ndihmuar dhe agresori ishte sanksionuar. Ish-zëdhënësi i Departamentit të Shtetit Amerikan për “Demokracia.com” thotë se për sa kohë që populli dhe liderët e Kosovës u qëndrojnë prapa parimeve demokratike dhe të tolerancës, parime këto që e kanë bërë Perëndimin të ndërhyjë, nuk ka arsye që Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti i Shtetit të mos e shohin Kosovën vend mik dhe vend me të cilin vazhdojnë të jenë krenarë që e kanë ndihmuar

takoj udhëheqësit e tyre. Kam takuar Millosheviqin, Tugimanin, Izetbegoviqin. Në Serbi shkuam nga Dubrovniku, ku ishim dëshmitarë të bombardimit të qytetit të vjetër dhe të kërcënimeve të luftës. Aty për herë të parë pashë sa i madh ishte dallimi mes palëve ndërluftuese. Në njërin anë kishte civilë të armatosur, ndërsa mbi kodra artileri serbe. Ishte luftë e vërtetë dhe unë u ndjeva i tmerruar. Fillova të mendoj se çfarë do të mund të bënim që ta ndalnim luftën. Fillova të mendoj sa brutale dhe sa e pakuptimtë ishte kjo që po ndodhte në një vend në Evropë. Kur shkuam në Serbi, e takuam Millosheviqin dhe dëgjua shpjegimet e tij pse duhej të bëhej luftë. Aty fillova të kuptoj më mirë çdo gjë. Na dërguan edhe në Prishtinë. Ajo që më kujtohet qartë është takimi me Ibrahim Rugovën, në selinë e partisë së tij. Patëm një bisedë të zakonshme. Por, ai në mënyrë bindëse tregonte realitetin e tij, ashtu që nga ai ndaheshe duke thënë më vete “do të bëj diçka

për këtë”. Ishte bisedë intelektuale, e drejtë dhe inspiruese. Por, më inspiroi edhe më tepër qëndrimi në hotelin “Grand” dhe takimi aty me një njeri që dukej se punonte për një organizatë ndërkombëtare. Ishte shqiptar i Kosovës dhe ishte i gatshëm të takohej me zyrtarët amerikanë dhe të tregojë për jetën në kushtet që ngjasonin me ato të apartheidit. Aty, në anën tjetër të dhomës, ishte Shesheli. Dhe ta shihje frikën në fytyrën e këtij njeriu që fliste me ne, të shihje sesi më fliste me frikë, atëherë pashë në të gjërat për të cilat kishim lexuar në libra dhe që dëgjoni për disidentët gjatë Luftës së Ftohtë, të ithtarëve të lirive e të drejtave të njeriut, këtyre heronjve të asaj kohe, se ishin të intimiduar nga pushteti dhe njerëzit e pushtetit. Më pas u mora me Bosnjën. Atje lufta po fillonte. Njerëzit ishin të frikësuar. Sarajeva, një qytet aq i gjallë, por ku tani njerëzit flisnin për atë që po vinte. Në një anë flisnin për tolerancë demokratike, për shoqërinë shumëmetnike, për bashkëjetesën

**Autor: Ardian ARIFAJ**

**Demokracia.com:** Si mësuat për Kosovën, si u bë që filluat të merreni me Kosovën?

**James Rubin:** Kur po mësoja për marrëdhëniet ndërkombëtare, për çështjet si kontrolli i armëve, për Bashkimin Sovjetik apo për

komunizmin në Evropën Lindore, asnjëherë nuk kisha ëndërruar që do të merrem me Kosovën. As që dija për Kosovën, për shqiptarët. Është një shembull që tregon se sa ironike është jeta, se sa të rastësishme mund të jenë gjërat, që një vend për të cilin mësova më vonë, u bë vend me të cilin tani kam një

lidhje unike.

Udhëtimi im i parë në rajon ishte në vitin 1992, gjatë luftës në Kroaci. Administrata e Bushit nuk ishte shumë e interesuar për rajonin, por unë si pjesë e delegacionit të Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë pata rastin t'i vizitoj të gjashtë republikat e Jugosllavisë dhe t'i

dhe në anën tjetër për atë se çfarë do t'u bënte lufta këtyre vlerave. Dhe, askush nuk dinte si ta evitonte luftën. Me Kosovën do të merresha më vonë. Në vitin 1993, në Bosnjë e solla senatorin Biden, për të cilin punoja atëherë. Bëra një raport dhe i tregova sa e rëndësishme ishte që ai të vinte. Kam punuar për, atëherë, senatorin Biden, për pesë vjet. Në atë kohë, për shkaqe familjare, nuk udhëtonte shumë. Por, erdhi në rajon dhe vizitoi Kroacinë, Bosnjën, Serbinë. Nuk erdhëm në Kosovë, por ishte koha kur lufta në Bosnjë ishte në kulm. Ai bëri një raport për presidentin amerikan dhe sekretarin e shtetit, ku kërkonte fuqishëm sulmet ajrore. Pastaj jeta më dërgoi në administratën Clinton që tanimë ishte në pushtet. Madeleine Albright njihej si ndër zërat e vetëm që kërkonte diçka më konkrete dhe unë, si dikush që kërkonte diçka më shumë, kërkova të punoj me të. Ajo më mori në punë dhe udhëtova me të në Bosnjë. Kur ajo u bë sekretare e Shtetit, Kosova ishte kthyer në agjendë. Ishte koha pas Dejtonit, viti 1998. Prej aty gjërat janë të njohura për të gjithë.

**Demokracia.com:** *Pra, ke mësuar për rajonin, për vuajtjet e popujve të rajonit, për Kosovën në mënyrë më të shtruar. Ku hyn Kosova në karrierën tënde personale? Ke luajtur rol të rëndësishëm në çështjen e Kosovës. Pse ndodhi kjo?*

**James Rubin:** Për mua nuk ka asgjë të pazakontë këtu. Jam

rritur si një hebre amerikan, që gjithmonë ka menduar për atë se çfarë kishte në mendjet e njerëzve në Departamentin e Mbrojtjes dhe në Departamentin e Shtetit, në vitet e '40. Isha mësuar të mos i gjykoj njerëzit në bazë të përkatësisë etnike apo fetare, por në bazë të karakterit të tyre. Prandaj, kur pashë se çfarë po ndodhte në Bosnjë, në Kosovë, tërë kohën mendoja se çfarë do të bëja unë nëse do të isha në pozitë të kisha përgjegjësi dhe të isha në pozitë që të mund të bëja diçka. Në Bosnjë bëra çfarë munda, por në atë kohë Albright ishte ambasadore në Kombet e Bashkuara. Në kohën kur çështja e Kosovës doli në sipërfaqe, ajo ishte Sekretare e Shtetit dhe mund të bënte më shumë. Kështu, ajo dhe unë, punuam shumë afër në këtë çështje të veçantë. Ajo më dha rol më të madh sesa vetëm të zëdhënësit. Vërejtëm, që në fillim, se Kosova nuk është si Bosnja, por është e ngjashme. Ai që ishte i njëjtë si në Bosnjë ishte agresori, Millosheviqi dhe forcat serbe. Prandaj, nuk duhet të humbim vite me sanksione e diplomaci që nuk kishte kuptim, por të shikojmë se çfarë mund të bëjmë që ta parandalojmë gjenocidin para se të ndodhë. E jo të reagojmë pasi që të ndodhë. Besoj që nëse ka pasur rast ku ka pasur kërcënim për gjenocid dhe është reaguar për ta parandaluar atë, ku lidhshipi amerikan ka pasur rol vendimtar, kjo është Kosova.

**Demokracia.com:** *Lufta ka mbaruar para më shumë se dy*

*dekadave. Kosova është shtet që 13 vjet. Si e sheh Kosovën sot?*

**James Rubin:** E kam vizituar Kosovën disa herë edhe pasi e kam përfunduar shërbimin në qeverinë amerikane. Sa herë kam ardhur, më duhet të jem i sinqertë, Kosova më është dukur e pakëndshme, jo aq atraktive fizikisht e shpirtërisht. Prishtina ende nuk duket si kryeqytet tjerë të Ballkanit. Por, sa më shumë vija, fillova të shoh se nuk është shumë më ndryshe nga kryeqytetet tjera të Ballkanit. Shtëpitë tani ishin të ndërtaura, rrugët ishin të pastra, nuk kishte më frikë nëpër rrugë. Dhe nuk dallonte shumë prej vendeve tjera. Sllovenia e Kroacia vërtetë janë më të pasura, Mali i Zi e Maqedonia ishin pak më ndryshe, por për sytë e një amerikani, të gjitha dukeshin bukur të ngjashme. E mbaj mend se isha kritikuar nga pjesëtarë të shërbimit të jashtëm amerikan dhe nga gazetarë, se i kishim vënë të gjitha "bastet" në UÇK-në dhe Hashim Thaçin. Kishte prej atyre që thoshin se po bënim gabim të madh, se duhej ta përkrahim Rugovën. Por, përgjigja që përsëri e them ishte se ne apo unë bashkëpunuam me Hashim Thaçin, sepse delegacioni kosovar e zgjodhi atë udhëheqës të delegacionit. Unë nuk e zgjodha, por ata. Ndërsa, ne e kishim strategjinë që të bashkonim Evropën kundër Serbisë, duke bindur kosovarët që të thoshin "Po" dhe Serbia të thotë "Jo". Dhe kjo strategji funksionoi vetëm sepse Hashim Thaçi ishte mjaft i mençur sa të nënshkruante Marrëveshjen e

Rambujesë dhe serbët jo. Shumë lehtë ka mundur të ndodhë që kjo të mos bëhej. Lehtë ka mundur të ndodhë që e tëra të shembej. Më vonë, pas luftës, kam dëgjuar të njëjtat fjalë: pse po shkon në konferencë para gazetarëve me të, pas demobilizimit të UÇK-së? Kisha përsëri të njëjtën përgjigje. NATO donte që UÇK-ja të demobilizohej.

Dhe, udhëheqësit e UÇK-së nuk kishin frikë t'i dorëzonin armët, edhe pse ishin fitimtarë. Asnjëherë, në asnjë kryengritje, nuk kishte ndodhur që ushtria kryengritëse të dorëzonte armët. Përsëri Hashim Thaçi ishte ai që nënshkroi marrëveshjen. Më kontaktoi, më konsultoi dhe unë i thashë që të mos priste, por ta mbaronte këtë punë, që ta përfundonim edhe këtë me sukses. Pra, përsëri ishte UÇK-ja e cila zgjodhi atë që ta nënshkruante.

Kështu u zhvillua një marrëdhënie e besimit me të. Fillova ta shoh si njeri që e mban fjalën. Nuk e gjykova në bazë të thashethemeve të cinikëve dhe skeptikëve të Evropës që thoshin të mos e dëgjoja atë. Pra, nuk e gjykova në bazë të paragjytimeve, por në bazë të bashkëpunimit me të. Dhe në vitet që pasuan ai u dëshmuar një politikan i vërtetë, si dikush që ka mbështetur zhvillimin demokratik. Njerëzit ndoshta nuk pëlqejnë çdo gjë që ka bërë ai. Asnjë politikan nuk mund ta arrijë këtë. Por, shikojeni situatën sot, kur ai dhe qeveria e tij ka ndërtaur këto procedura ekstreme për ndjekjen e krimeve të luftës, gjë që askush nuk e ka

bërë deri më tani. Edhe vetë iu ka nënshtruar këtyre procedurave. Ideja se ka diçka të keqe në të, u tregua e gabuar. Do të vazhdoj ta gjykoj në bazë të përvojës sime me të. Asnjëherë nuk kam parë fakte për përgjegjësinë e tij për krime që sigurisht që ndodhin në luftë, nga një popullatë që vuan nga një sulm i madh. Por, ta lidhësh atë me këto, pa pasur fakte, është "guilt by association" dhe kjo është e gabuar.

**Demokracia.com:** *Ku është Kosova sot?*

**James Rubin:** Gjërat nuk zhvillohen shpejt. Vetëm gjatë kohës sa e kam njohur atë, Kosova ka kaluar nga koha e atij njeriut në hotelin "Grand" që frikësohej të flasë, te heqja e kërcënimit serb e deri te shpallja e pavarësisë, që është pranuar nga shumica e shteteve. Por, është frustruese ngecja dhe janë dy pengesa prej të cilave nuk dihet se cila vjen e para, e cila e dyta. Disa thonë se problemi i parë është se zhvillimi i Kosovës ngec nga mungesa e njohjes ndërkombëtare. Dhe, të tjerët thonë se ky është vetëm arsytim për një sistem politik të ngecur. Duket se këtë herë votuesit e Kosovës u kanë dhënë përparësi këtyre të dytëve dhe dëshirojnë ta provojnë këtë. Te liderët e rinj nuk e shoh gatishmërinë që ta zgjidhin çështjen e njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Liderët e rinj duket se kanë prioritete tjera. Këta janë njerëzit që nuk janë pajtuar as me Rambujenë, pa të cilën nuk do ndodhnin të gjitha tjerat.



Këta do të provojnë të zgjedhin problemet përbrenda dhe nuk do ta shohin mungesën e njohjes ndërkombëtare dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara, në NATO, në BE, si arsye pse zhvillimi i Kosovës është i kufizuar.

Mbetet të shihet nëse e kanë mirë. Shpresoj që e kanë mirë. Shpresoj që gjërat mund të rregullohen. Edhe ashtu, tash për tash, nuk shoh që ka liderë në Kosovë dhe Serbi, që janë të vendosur t'i zgjidhin çështjet e hapura dhe të arrijnë paqe. Kjo është për keqardhje, por është fakt.

**Demokracia.com:** *Cili është roli i administratës së re amerikane? Presidenti Biden ka vizituar rajonin disa herë, e përmendët edhe vetë. Sekretari i Shtetit, Blinken, e njuh rajonin mirë. E njuh Kosovën, pasi është marrë me të më herët. Si do të reflektojë kjo në Kosovë dhe në rajon?*

**James Rubin:** E ardhmja e Kosovës, në këtë fazë, duke u nisur nga ajo që e thamë më herët, është në duart e liderëve politik që ka vendosur të ndez vetëm "motorin" e ndryshimeve të brendshme dhe të mos merret shumë me faktorët e jashtëm si njohjet, njohja reciproke me Serbinë, anëtarësimi në Kombet e Bashkuara. Kjo nuk duket se do të jetë prioriteti i tyre. Pra, nuk besoj se evolucioni i Kosovës në të ardhmen e afërt do të varet nga ajo se kush është në Shtëpinë e Bardhë. Kjo do të ishte e rëndësishme nëse do të ekzistonte dëshira për të arritur marrëveshje finale të paqes. Për fat të mirë për Kosovën, kemi një President në Shtëpinë e Bardhë dhe një Sekretar të Shtetit, të cilët e kanë Ballkanin si një nga momentet përcaktuese të angazhimit të tyre në politikën e jashtme, kur lideri amerikan ka qenë vendimtar, kur viktimat janë ndihmuar dhe agresori është sanksionuar. Nuk besoj që Biden dhe Blinken do ta harrojnë këtë. Biden e konsideron punën e tij në Bosnjë si një nga të arriturat më të mëdha të kohës sa ka qenë senator. Nuk besoj se do të harrojë se kush në cilën anë ishte në atë kohë.

Dhe, për sa kohë që populli i Kosovës dhe liderët e Kosovës u qëndrojnë prapa parimeve demokratike dhe të tolerancës, parime këto që e kanë bërë Perëndimin të intervnojë, nuk ka arsye që Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti i Shtetit të mos e shohin Kosovën si vend mik dhe vend që jemi krenar që e kemi ndihmuar.

**Demokracia.com:** *A mund të presim bashkëpunim më të*

*madh të Uashingtonit me kryeqendrat evropiane për çështjen e Kosovës dhe të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi?*

**James Rubin:** Përgjigjja e menjëhershme është "PO". Administrata e kaluar nuk ishte e interesuar apo nuk ishte e aftë që të bashkëpunojë me partnerët në NATO. I kishte vënë prioritet të ulët bashkëpunimit me diplomacinë evropiane. Nuk ishte e interesuar për këtë. Nëse do të kishte sukses në arritjen e marrëveshjes finale, kjo do të ishte interesante, por nuk ia dolën. As që e filluan. Nuk është se do të isha kundër, mos të keqkuptohem. Nëse do të gjendej një zgjidhje që do të sillte njohje reciproke me Serbinë, nuk shoh arsye pse Shtetet e Bashkuara do të thoshin "nuk jemi të kënaqur me këtë, të kërkojmë një marrëveshje më të mirë". Kjo nuk ka kuptim. Por, kjo nuk ndodhi.

Tash jemi në një situatë kur rruga evropiane është ngadalësuar, të mos them është marginalizuar si politikë. Ka probleme të mëdha në Bosnjë e Hercegovinë. Ka rreziqe të mëdha në Kosovë. Besoj se do të ishte më mirë që administrata të zgjedh që të bashkëpunojë me evropianët – dhe besoj se do të bëjë këtë – dhe të luajë rol më të madh në Kosovë dhe rajon. Kohët e fundit, Amerika është tërhequr, që është e kuptueshme sepse Kosova është në Evropë. Rreziku për një luftë të re është i vogël. Prandaj është më e duhur që fqinjët të luajnë rol më të madh. Pra, do të ketë bashkëpunim ose të themi më mirë - do të ketë një nivel të sinkronizimit.

**Demokracia.com:** *A mendoni se ky është çelësi për sukses në dialog?*

**James Rubin:** Nuk besoj se çelësi për sukses në dialog është në duart e aktorëve të jashtëm. Mendoj se çelësi i suksesit në dialog është në duart e liderëve në Kosovë dhe në Serbi. Çështjet nuk duhet t'u nënshtrohen presionit nga jashtë, të detyrohet një shtet të njoh një shtet tjetër, të bëjë një shtet t'i harrojë të gjitha pasojat e luftës. Kjo nuk është në duart e vendeve perëndimore. Ne besojmë se edhe vendet e vogla kanë të drejta të njëjta dhe janë të barabarta me ne. Askush nuk mund t'u thotë se çfarë duhet të bëjnë. Këtë e bëjnë vetëm Rusia e Putinit dhe Kina e Xi-së në fakt. Ato thonë "jemi shtet i madh dhe mund t'u themi të tjerëve se çfarë të bëjnë". Është në duart e vetë shteteve të vendosin se çfarë do të bëjnë. A duhet t'i ndihmojmë, a duhet t'u ofrojmë incentiva? Përgjigjja është "po".



Por, a duhet të jemi faktor vendimtar? Jo, nuk duhet të jemi. Nëse ka liderë që janë të gatshëm të bëjnë punën e vështirë e të nevojshme, ne duhet të jemi të gatshëm t'i ndihmojmë. Por, nëse kjo u duket se është shumë e rëndë dhe shumë e vështirë për ta, ne nuk mund të ndihmojmë.

**Demokracia.com:** *A mund të presim që të keni rol në Kosovë dhe në rajon si pjesë e administratës së re?*

**James Rubin:** Puna që kam bërë në Kosovë dhe kontaktet me miqtë e mi atje është punë me të cilën krenohem më së shumti nga koha sa punova në qeveri. Jam krenar që njerëzit si Presidenti Clinton, si Sekretarja Albright dhe unë patëm

mundësi të bëjmë ndryshime të vërteta për njerëzit. Jam krenar për këtë. Jam krenar sesi është rritur Kosova, edhe pse nuk është e përsosur, nuk është pa vështirësi. A do të kem ndonjë rol në të ardhmen? Në sistemin tonë kjo nuk varet nga unë. Do të ishte mashtrim të them se nuk më intereson puna në qeveri. Më intereson. Kam punuar për Presidentin Biden për katër vite kur ai ishte senator. E njoh shumë mirë Sekretarin e Shtetit. Dhe nëse më kërkojnë që të ndihmoj në mënyrë diplomatike në Evropë, do të isha i nderuar. Nëse më kërkojnë të bëj diçka të rëndësishme në Azi, edhe këtë do ta pranoja. Por, nuk e di. Shpresoj që, pa marrë parasysh se si, të

jemi në gjendje të ndihmoj.

**Demokracia.com:** *Cili do të ishte mesazhi juaj për Kosovën dhe kosovarët tani në këto rrethana që i përshkruat?*

**James Rubin:** Të shpresojmë që njerëzit në Kosovë dhe liderët e tyre do të jenë të sinqertë me veten e tyre për atë se çfarë duhet të bëhet që të ecet përpara. Në demokraci - dhe ne e kemi mësuar këtë në periudhën e Trumpit - është e lehtë për liderët që të premtojnë gjithçka e të mos arrijnë asgjë, siç ka bërë Trumpi me premtimet për marrëdhëniet ndërkombëtare. Kur liderët premtojnë se çdo gjë do të jetë e lehtë dhe çdo gjë do të zgjidhet, zakonisht e kanë gabim.

# 500 punëtorë shëndetësorë të Kosovës morën vaksinën kundër Covidit në Shqipëri

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 MARS - Në Kukës të Shqipërisë ka vazhduar edhe të dielën vaksinimi kundër koronavirusit i punëtorëve shëndetësorë të Kosovës. Në këtë fazë Shqipëria do të imunizojë rreth 500 punëtorë shëndetësorë të Kosovës me vaksinën e "AstraZeneca"-s.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka premtuar se kjo ndihmë do të vazhdojë sapo ky vend të ketë furnizime të reja me vakcina. Shqipëria vendosi të ofrojë vaksinim për punëtorët shëndetësorë pasi Kosova ende nuk ka siguruar doza të vaksinës kundër Covid-19.

Kosova vazhdon të mbetet vendi i vetëm në Evropë që nuk ka nisur procesin e vaksinimit. Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka falënderuar Qeverinë e Shqipërisë për mundësinë që i ofruan një numri të punëtorëve shëndetësorë të Kosovës që të vaksinohen kundër Covid-19 në Kukës. "Në emër të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës falënderojmë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, përkatësisht kryeministrin Rama dhe ministren Manastirliu, për

mundësinë që u dhanë një numri të konsideruar të profesionistëve shëndetësorë nga Kosova që të vaksinohen kundër Covid-19 në Kukës. Gjithashtu, një falënderim i veçantë edhe për profesionistët shëndetësorë të Shqipërisë që me etikë dhe profesionalizëm të lartë administruan dhënien e vaksinave të kolegët e tyre kosovarë përgjatë këtyre dy ditëve, bashkë me të gjithë ata që kontribuuan për realizimin e vaksinimit (ambasadorin Hasani, FSSHK-në etj.), që si akt, përtej çdo simbolike, tregon rëndësinë e bashkëpunimit midis dy shteteve në funksion të mbrojtjes sa më adekuate kundër Covid-19", ka thënë Zemaj.



## Tetë të vdekur dhe 793 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 4 838 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 793 raste

pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (80, 63 vjeç), Ferizaj një rast (63 vjeç), Gjilan një rast (83 vjeç), Kaçanik një rast (84 vjeç), Klinë një rast (81 vjeç), Mitrovicë një rast (72 vjeç), Prizren një rast (78 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 82 185 raste nga 384 742

persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 760 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 352 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 68 083 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12 342.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 295 raste, Gjilan 63 raste, Fushë-Kosovë 58 raste, Pejë 53 raste, Gjakovë 38 raste, Mitrovicë 39 raste,

Vushtrri 38 raste, Lipjan 34 raste, Ferizaj 30 raste, Drenas 17 raste, Obiliq 15 raste, Podujevë 15 raste, Deçan 13 raste, Rahovec 13 raste, Kamenicë 10 raste, Klinë 10 raste, Prizren 9 raste, Shtime 9 raste, Suharekë 6 raste, Istog 5 raste, Kaçanik 5 raste, Skenderaj 4 raste, Viti 4 raste, Malishevë 3 raste, Novobërdë 3 raste, Dragash 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë dhe Klokot.

## Në Universitetin 'Ukshin Hoti' u mbajt Konferenca XV Ndërkombëtare Ndërdisciplinore

PRIZREN, 21 MARS (ER) - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, më 19 dhe 20 mars 2020, ka zhvilluar punimet Konferenca IV Ndërkombëtare e Forumit Sociologjik Ballkanik (BSF) "Ballkani - një qasje krahasuese dhe integruese" dhe Konferenca XV Ndërkombëtare Ndërdisciplinore: "Studime krahasuese në shoqërinë moderne, Ballkani në kontekstin evropian dhe global". Konferenca ka zhvilluar punimet në mënyrë të kombinuar, online dhe fizikisht. Në këtë konferencë janë



prezantuar 223 punime nga 333 autorë e koautorë nga 23 shtete. Nikoqiri i kësaj konference, rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, në fjalën hyrëse ka theksuar se mbajtja e kësaj konference është e rëndësime për universitetin që drejton, për Kosovën, për rajonin por edhe për shkencën në përgjithësi. Në hapje të punimeve të kësaj konference, një fjalë rasti e mbajti edhe studiuesi dhe ambasadori dr. sc. Sabri Kiçmari. Ai ka theksuar se Ukshin Hoti, nga ambientet e

larta institucionale dhe shkencore, regjimi e zbrit në burg për shkak të bindjes së tij politike dhe kërkesës së tij për republikë. Koordinatorin e kësaj konference i ka falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë për realizimin e kësaj konference, në veçanti rektorin Temaj, nën përkujdesjen e të cilit është bërë organizimi i kësaj konference. Kjo konferencë ka qenë e paraparë të mbahet në nëntor të vitit të kaluar, por është shtyrë për këtë muaj për shkak të situatës me pandeminë.

## Qeveria zotohet për trajtimin e barabartë të fëmijëve me Sindromën Down

PRISHTINË, 21 MARS (ER)- Në Ditën Botërore të Sindromës Down, kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka thënë se Qeveria e Kosovës edhe një herë zotohet se do t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë për trajtim të barabartë dhe për krijimin e

kushteve të nevojshme për shkollimin dhe zhvillimin e fëmijëve të prekur me këtë sindromë. "Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gjithnjë gatishmëri dhe vullnet për të vënë në dispozicion gjithë mekanizmat e nevojshëm për t'ua mundësuar të

prekurve me Sindromën Down, që t'i gëzojnë të gjitha të drejtat, duke filluar nga shkollimi deri te krijimi i kushteve për jetë të pavarur, përmes mbështetjes së aftësive dhe talenteve të tyre të jashtëzakonshme", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".



# Qeveria dhe institucionet e reja të Republikës së Kosovës, disa prioritete dhe sfida

**Burim BREZNICA**

Në demokracitë perëndimore është me rëndësi që qeveritë të qeverisin dhe të jenë në shërbim të qytetarëve. Demokracia në një vend kërcënohet dhe e humb besueshmërinë nëse politikanë të papërgjegjshëm premtojnë se do të realizojnë gjëra të ndryshme ose të mëdha dhe nuk i bëjnë ato. Realizimi i premtimeve është i rëndësishëm edhe për qytetarët sepse ka të bëjë me jetën e tyre ditore, pastaj me arsimimin, me shëndetin, me sigurinë, me ekonominë etj.

Në librin e tyre, Why Nations Fail (Pse dështojnë shtetet/kombet), autorët D. Acemoglu dhe J. Robinson thonë se dallimi kryesor pse disa qeveri janë të suksesshme e të tjerat jo "ka të bëjë me atë se sa janë qeveritë efektive dhe të përgjegjshme dhe si ndjekin politikën dhe strategjitë publike inklusive në raport me ato qeveri që ndjekin interesat e elitave ose grupeve të tyre të ngushta" (Crown Business New York, 2012).

Kurse profesori amerikan F. Fukuyama në librin e tij, The origins of Political Order (Origjina e Rendit Politik) thotë se një vend për të dalë nga "ekuilibri jofunksional" si e quan ai, duhet të bëjë reforma radikale politiko-ekonomike ose të ketë leadership të fortë ose duhet t'i ketë të dyja së bashku (Profile Books Ltd, 2012).

Pas mbajtjes së suksesshme të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë më 14 shkurt 2021 dhe pas certifikimit të tyre, tani është në radhë konstituimi dhe zgjedhja e liderëve të institucioneve të reja, duke filluar nga Kuvendi i Kosovës, të hënën më 22 mars.

Është me rëndësi për Kosovën dhe të gjithë qytetarët që konstituimi i këtyre organeve të bëhet pa vonesa, duke përfshirë edhe zgjedhjen e presidentit/es për arsye se Kosova ka shumë punë për të bërë, shumë prioritete dhe sfida që i duhet t'i adresojë. Sigurisht, përgjegjësia kryesore bie mbi partinë fituese dhe listën e tyre të përbashkët por edhe opozita ka përgjegjësi të madhe që të kontribuoj në stabilitet institucional dhe duhet të jap kontributin e saj (sidomos ato parti që thirren si institucionale) për konstituim sa më të shpejtë të institucioneve të reja dhe të evitohen shkuarjen eventuale në zgjedhje të reja. Në të kundërtën, Kosova do të humbiste edhe më shumë kohë të vlefshme në kohë pandemike, në vend që të merret me disa prioritete të rëndësishme dhe sfida të vështira që e presin Kosovën dhe qytetarët do të pësonin pa nevojë.

Me siguri, çdo parti politike ka një program më të cilin konkurron në zgjedhje dhe kanë edhe idetë dhe planin e tyre se si do të qeverisin me vendin. Parti të tjera punojnë me programe politike në vazhdimësi dhe i ndryshojnë dhe

plotësojnë sipas nevojave. Kjo është normale në çdo vend demokratik të botës.

Një qeveri si rregull ka një strategji dhe planifikim, pastaj resurset, standardet dhe buxhetin për të realizuar një program qeveritar. Rutina dhe ekspertiza është me rëndësi po ashtu, një qeveri me rutinë cakton prioritete të qarta, ka objektiva dhe plan të qartë, përcakton afatet kohore, bën dialog me palët e përfshira, mat suksesin, është transparente dhe konsistente, është e përgjegjshme etj.


Një qeveri duhet të ketë prioritete dhe të merret me to së pari dhe të realizoj ato përmes ministrave dhe institucioneve përkatëse që janë me rëndësi për vendin. Për mendimin tim, disa nga prioritete (pa i renditur sipas rëndësisë) dhe sfidat makro të Qeverisë së re të Kosovës mund të jenë si në vazhdim.

## Disa nga prioritetet e brendshme të qeverisë së re dhe institucioneve të tjera duhet të jenë:

Pandemia - marrja me ketë problem duhet të jetë prioritet i qeverisë së re sepse është në pyetje shëndetësia e popullsisë dhe sigurimi i vaksinave është jetik për Kosovën. Qeveria e deritanishme nuk ka qenë aq sa duhet serioze dhe fatkeqësisht nuk ka arritur të siguroj vaksina shumë të nevojshme kundër Covid-19, gjersa shtete të tjera nga rajoni dhe më gjerë janë treguar më efikase sesa Kosova.

Reformimi i Administratës Publike - Kosovës i duhet një reformim i thellë dhe ideja bazë duhet të jetë që punonjësit shtetëror të punësohen në bazë të meritokracisë dhe profesionalizmit, edukimit relevant etj. e jo sipas militantizmit partiak apo servilizmit, siç është bërë deri më tani në disa raste, fatkeqësisht. Këto dukuri janë raportuar shpesh edhe në mediet vendore. Në këtë kontekst po përmend vetëm disa prioritete kryesore për administratën në planin makro.

Riorganizimi dhe rifunksionalizimi i MPJD - është me rëndësi strategjike për Kosovën që të bëjë një riorganizim, rifunksionalizim të shërbimit jashtëm diplomatik i cili do të bazohet në meritokraci, profesionalizëm, përvoja dhe shkathhtësi gjuhësore në rend të parë. Do të duhet të krijohej një program për "kthim të trurit" apo skemë "Brain gain" për kthim të specialistëve të fushave të ndryshme nga diaspora ku do të paguheshin p.sh. për një vit nga Qeveria e Kosovës, me mundësi vazhdimi dhe ku do të mund të përfshiheshin bonuse shtesë për të tërhequr inteligjencën shqiptare nga jashtë që të kontribuoj për



Kosovën. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme për shtetin e Kosovës që të pajiset me njohuritë e fundit dhe ekspertizën ndërkombëtare në shërbim të vendit. Një program të ngjashëm e kanë zbatuar vende të tjera si p.sh. Koreja e Jugut në vitet 1960 dhe Tajvani në vitet 1970 dhe të tjera më vonë etj.

Prioritet tjetër duhet të jetë reformimi i sistemit të arsimit sidomos i atij të lartë dhe të bëhet, p. sh., lidhja e njohurive dhe teorive akademike me tregun e punës etj. Sistemi shëndetësor duhet gjithashtu të përkrahet dhe të ndihmohet financiarisht por njëkohësisht edhe të reformohet dhe të specializohet edhe më tej. Të bëhen specializime dhe trajnime të personelit mjekësor jashtë vendit dhe të ndiqen zhvillimet e fundit globale në fushën e mjekësisë etj. Në fushën legjislativë është me rëndësi që të përgatitet projektligji për konfiskim të pasurisë së paligjshme dhe luftimi i korrupsionit sepse kjo do të mundësojë forcim të shtetit ligjor, mjete financiare shtesë që do të duhej të derdheshin aty nga ku janë "marrë" në buxhetin e shtetit ose të kompanive publike. Po ashtu projektligji për diasporën duhet të jetë prioritet në mënyrë që t'i mundësohet diasporës Kosovare të ushtrij të drejtën e tyre kushtetuese dhe të votojnë në ambasada e konsullata të Kosovës në vendet ku jetojnë dhe banojnë ata.

Në fushën e ekonomisë është me rëndësi të stimulohet ekonomia e vendit të krijoj vende pune, të tërhiqen investimet e jashtme, të zhvillohen turizmi, bujqësia etj. Pastaj të rishikohen dhe të bëhen auditime tek kompanitë publike nga profesionistë të pavarur dhe të veprohet në bazë të rekomandimeve të tyre. Është me rëndësi që të sigurohen qytetarët që edhe kompanitë publike duhet kryejnë shërbime për ta në rend të parë dhe jo për interesa personale apo grupe sic ka ndodhur në raste të ndryshme dhe si pasojë ishin shkarkimet e disa bordeve të kompanive nga Qeveria Kurti I.

Forcimi i ushtrisë dhe armatimi i saj modern, pastaj forcimi dhe trajnimi i policisë së Kosovës duhet të jenë prioritete të qeverisë së re sepse në rajonin e Ballkanit ka forca të errëta që janë të interesuara të destabilizojnë Kosovën, kjo shihet qartë nga sjelljet e tyre me qasje bizantine, pastaj lojërat me harta dhe nga provokimet e tyre të vazhdueshme. Reformimi i KQZ-së është tepër i rëndësishëm për demokracinë dhe besueshmërinë në Kosovë. KQZ në bazë të Kushtetutës është një organ i pavarur por fatkeqësisht detyrën e ka kryer duke ju shërbyer interesave të individëve dhe partive të caktuara. Caktimi i kryetarit/es së KQZ-së është në kompetencë të presidentit/es. Kryetarja aktuale do të duhej të shkarkohej për keqmenaxhim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, duke qenë e njëanshme, joprofessionale dhe duke ua mohuar të drejtat kushtetuese një pjesë të madhe të diasporës që të votojnë në zgjedhjet kombëtare. Natyrisht përgjegjësinë së bashku me të e ndajnë edhe ata përfaqësues të partive politike aty që kanë marrë dhe përkrahur vendime të tilla. Duhet shqyrtuar mundësitë të reformohen edhe puna e këshillave dhe sekretariatit të KQZ-së dhe kjo do të duhej të ishte një detyrë me rëndësi e juristëve duke u koordinuar së bashku me parlamentin dhe institucionet tjera të vendit, në mënyrë që KQZ-ja të jetë në shërbim të Kosovës.

## Disa nga prioritetet e jashtme të qeverisë së re dhe institucioneve të tjera

Këto prioritete janë: arritja e njohjeve të reja nga shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën dhe koordinimi më intensiv me Shqipërinë në këtë drejtim, anëtarësimi i Kosovës në NATO dhe BE-në dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Kultivimi dhe vazhdimësia e raporteve speciale me ShBA-në. Tjetër prioritet duhet

të jetë tërheqja e investimeve të jashtme në Kosovë etj.

## Disa nga sfidat e qeverisë dhe institucioneve të tjera në planin e brendshëm

Pandemia ashtu si prioritet është njëkohësisht edhe sfida e madhe të luftosh "një armik të padukshëm" dhe jo vetëm për Kosovën prandaj duhet angazhuar resurse dhe financa shtesë që të ndihmohen dhe mbrohen qytetarët e Kosovës sepse është në pyetje jeta dhe siguria e tyre. Sigurimi i vaksinave duhet të jetë prioritet absolut. Sfida të tjera do të jenë zgjedhja e presidentes/it (kjo mund të jetë në afat të shkurtër), pastaj sundimi i ligjit, papunësia dhe zhvillimi ekonomik, integrimi i veriut të vendit etj.

## Disa nga sfidat e qeverisë dhe institucioneve të tjera në planin e jashtëm

Disa nga këto sfida janë: njohjet nga 5 vendet anëtare të BE-së, anëtarësimi në organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare si, p. sh., OKB, OBT etj., pastaj dialogu me Serbinë dhe njohja reciproke, arritja e sa më shumë njohjeve nga shtete të reja etj.

Për të realizuar prioritete dhe për tu përballur me sfidat e ardhshme, është me rëndësi të bëhet reformimi i administratës publike që e theksova më lartë sepse Kosova mund të përgatitet shumë më mirë. Siç ka thënë profesori amerikan Fukuyama: "institucionet dhe organizatat më efikase janë ato që kanë strategji dhe programe të mira, që udhëhiqen nga liderë/zyrtarë të aftë, me përvojë dhe që nuk kanë kufizime apo kontroll burokratik të panevojshëm" (State Building, 2005, Cornell University Press). Kurse ish-kancelari gjerman Bizmark ka deklaruar një herë kështu: "Nëse ke ligje të këqija por zyrtarë shtetërorë (shërbyes civilë) të mirë ... ju prapë mund të qeverisni, por nëse keni zyrtarë civilë të ngathët/jo efikas, as ligjet më të mira në botë nuk mund t'ju ndihmojnë në qeverisje".

Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera kanë para vetes prioritete dhe sfida të mëdha, por edhe mundësi që të punojnë seriozisht dhe t'i realizojnë dhe adresojnë ato dhe kjo do të ishte ajo që e duan qytetarët e Kosovës, për të mirën e tyre të përbashkët.

*(Autori ka specializuar në Administratë Publike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, në Universitetin e Stokholmit. Pikëpamjet janë personale dhe nuk përfaqësojnë institucionin suedez ku ai është i angazhuar (Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë, Administrata Tatimore e Suedisë).*



## Në fondin për menaxhimin e Covid-19 u grumbulluan 716 mijë euro

Më 12 prill bëhet një vjet prej që ish-kryeministri Albin Kurti i bëri thirrje diasporës t'i ofrojë ndihmë materiale Kosovës për t'u solidarizuar me situatën që po kalonte vendi me pandeminë Covid-19. Ai u kishte kërkuar qytetarëve të Kosovës, rezidentë në vendet e tjera, të kontribuojnë për tejkalimin e situatës me pandeminë. Në nënllogarinë e hapur, që është pjesë e sistemit të llogarisë së vetme të Thesarit dhe mbahet në Bankën Qendrore të Kosovës, deri më 31.12.2020 qenë mbledhur gjithsej 716 773.93 euro, mirëpo se a janë dhe si janë shpenzuar këto mjete ende nuk është bërë me dije nga Ministria e Financave dhe Transfereve



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINE, 21 MARS** - Në fondin për menaxhimin e pandemisë Covid-19 që nga muaji prill i vitit të kaluar në Thesarin e shtetit janë grumbulluar 716 mijë e 773 euro e 93 centë. Prej kësaj shume 667,115.70 euro janë grumbulluar nga jashtë Kosovës (duke përfshirë jo vetëm mjetet nga diaspora, meqë ka pasur edhe donatorë institucionalë), kurse transferimet e brendshme (nga qytetarë brenda Kosovës) janë 49,658.23 euro. Se a janë dhe si janë shpenzuar

këto mjete ende nuk është bërë me dije, mirëpo nga Ministria e Financave dhe Transfereve kanë theksuar se duhet pritur derisa të publikohen pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020 "Në aneksin nr. 23, nënllogaria e dedikuar për donacione dhe grante". "Në përputhje me autorizimet nga LMFPP, Thesari i Kosovës ka hapur një nënllogari zyrtare b a n k a r e (XK051000400070008037) të dedikuar për pranimin dhe evidentimin e fondeve që dedikohen në luftën kundër pandemisë Covid-19 (kryesisht garantëve dhe donacioneve),

me qëllim të rritjes së transparencës si dhe llogaridhënies sa më të lartë ndaj publikut si dhe partnereve tanë", është thënë në përgjigjen me shkrim të Ministrisë së Financave dhe Transfereve dërguar gazetës "Epoka e re".

Ndërkaq numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deri në fund të vitit 2018 vlerësohet të jetë mbi 850 mijë. Të pyetur lidhur me origjinën e dërgesave prej cilave shtete ka më së shumti mjete, sipas Ministrisë së Financave dhe

Transfereve, deri më datën e raportimit 31.12.2020 janë gjithsejtë 716,773.93 euro të mbledhura. "Nënllogaria e hapur është pjesë e sistemit të Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe mbahet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe është aktive, në të cilën janë pranuar edhe mbështetjet buxhetore dhe kreditë ndërkombëtare për menaxhim të pandemisë. Deri me datën e raportimit (31.12.2020) janë mbledhur gjithsejtë 716,773.93 euro, prej të cilave 667,115.70 euro nga jashtë Kosovës (duke përfshirë, por jo vetëm mjetet nga diaspora,

meqë ka pasur edhe donatorë institucionalë), kurse transferime të brendshme (nga qytetarë brenda Kosovës) janë 49,658.23 euro. Në këtë llogari janë pranuar edhe fonde të tjera që janë mbështetje buxhetore nga institucionet financiare ndërkombëtare, por që nuk janë të përfshirë në këtë shumë, meqë pyetja juaj ishte specifike", është theksuar në përgjigjen e Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Kjo ministri ka theksuar se për më shumë hollësi rreth kësaj çështjeje do të dihet kur të publikohen pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020.

## OEK-u kërkon zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbje dhe faljen e gjobave



**PRISHTINE, 21 MARS** - Kryetari i Odës Ekonomike i Kosovës, Berat Rukiqi, ka deklaruar se bizneset nuk po përfitojnë nga Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike, ku ishte paraparë mbështetje prej 200 milionë eurove. Rukiqi në një konferencë për media i ka bërë

thirrje qeverisë për faljen e gjobave që janë shqiptuar gjatë kërkesave për zbatimin e masave dhe mundësinë për një amnisti fiskale për bizneset. "Ajo çfarë është zhgënjyese tani për tani, moszbatimi i Ligjit për Rimëkëmbjen. Është një nen në

Ligjin për Rimëkëmbjen që 200 milionë euro do të duhet të ishin përkrahje e drejtpërdrejtë financiare për bizneset. Pra, 200 milionë euro dhe kjo nuk është reflektuar as në buxhet dhe as në vendimet e qeverisë. Deri tani përfitimet e biznesit nga Ligji për

Rimëkëmbjen janë minimale. Gjithashtu, qeveria në ardhje duhet ta trajtojë me shumë kujdes edhe mundësinë e një amnistie fiskale dhe faljes së gjobave që janë shqiptuar gjatë kërkesës për zbatimin e masave. Shumë gjoba kanë qenë

jashtëzakonisht të larta dhe nëse krahasohen me përkrahjen financiare që kanë marrë bizneset, del se shumë më e lartë është kostoja e gjobave sesa përkrahja që kanë marrë nga masat e ndryshme të rimëkëmbjes", ka thënë Rukiqi.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (12)

# Këto ishin esenciale në afishimin e 17 majit të vitit 1981



Shkruan: Bedri ISLAMI

Esenciale në afishimin e 17 majit të vitit 1981 ishte:

- Kosova do të qetësohet po të hiqet shtetdrejtësi, të tërhiqen ushtria dhe policia ndëshkuese serbe, të normalizohet gjendja, të lirohen të burgosurit e pafajshëm që kanë mbushur burgjet, t'u kthehen familjeve të vrarët e tyre në demonstrata, se kjo është një çështje e shenjtë dhe humanitare. Studioni me vëmendje dhe drejtësi kërkesën e popullit të Kosovës për republikë, zgjidhni drejt problemet ekonomike të saj. Vetëm kështu do të qetësohet Kosova [...]

- Kosova kërkon statusin e Republikës brenda Federatës Jugosllave. Ky status përfaqëson aspiratën e një populli të madh që kërkon me të drejtë "statusin e sovranitetit" dhe jo atë të "pakicës kombëtare", që padrejtësisht ka pasë qenë caktuar që në Jajcë.

- Kërkesa e Kosovës për të fituar statusin e republikës federale është e drejtë. Ajo këtë e ka merituar me luftën që ka bërë bashkë me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër fashizmit. Shovinizmi serbomadhe e ka gjakosur rëndë Kosovën dhe ka krijuar një situatë të tillë, që me ekspedientë zor se shërohet.

- Për sa iu përket atyre "udhëheqësve shqiptarë" që morën fjalën në këtë forum të lartë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ose jashtë këtij forumi, fjalimet e tyre u karakterizuan nga një histeri sa e madhe, aq edhe servile e shërbyese ndaj zotërinyve të tyre Vidiq, Miniq, Stamboliq etj. Kuptohet se këta "udhëheqës" fantoshë i urren populli i Kosovës.

- Shqiptarët janë një etni, një popull, quaje "Shqipëri të vogël" ose "Shqipëri të madhe". Këta shqiptarë të kësaj Shqipërie "të vogël" ose "të madhe", që përbëjnë një popull kompakt dhe që kanë të gjitha tiparet e një kombi të vërtetë, as kanë zaptuar tokat e të tjerëve, as kanë shkelur të drejtat e ndokujt. Ata vetëm të drejtat e veta kanë kërkuar, i kanë mbrojtur dhe do t'i mbrojnë. Këtë ju e gjeni të jashtënatyrshme, e quani "shqiptaromadhe", "nacionaliste", deri dhe "fashiste". Kur Kosova kërkon

statusin e Republikës brenda Federatës, për të cilën kanë luftuar 50 mijë partizanë, ju guxonin ta quani këtë një kërkesë kundërrevolucionare, nacionalizëm shqiptar e t'i ngjini plot epitetet të tilla.

\*\*\*

A ishte në dijeni Enver Hoxha për ngjarjet që po përgatiteshin në Kosovë në pranverën e vitit 1981?

Dikujt mund t'i duket absurde ngritja e një pyetje të tillë. Logjika e thjeshtë të çon tek mendimi se, derisa shteti shqiptar nuk ishte në dijeni, edhe ai, Enver Hoxha, që ishte nr. 1 i padiskutueshëm i shtetit, nuk mund ta dinte. Në këtë rast, njësimi i dijenisë së shtetit me atë që ka ditur Enver Hoxha mund të jetë i vërtetë, ashtu si edhe është e mundur që të ketë qenë ndryshe.

A mund të ngrihet një tezë e tillë? Thënë të drejtën, deri para disa vitesh, edhe unë nuk e kisha menduar kurrë se mund të ngrija një tezë të tillë. Duke ditur sot, atë që nuk kemi ditur dje, pra mekanizmin e fshehtë të shtetit shqiptar, nganjëherë deri në strukturat më të panjohura, duke pasur sot akses në pjesë të arshivave që kanë qenë rreptësisht të mbyllura, edhe mund të mendohet se, ndryshe nga pjesët e tjera të shtetit, ai mund të ketë qenë i përgatitur ose, më saktë, ka qenë në pritjen e asaj që potencialisht do të ndodhte, pa e ditur saktësisht se kur.

Në shtetin shqiptar kishte struktura të fuqishme të sigurimit të shtetit, sidomos të atyre segmenteve që merreshin me survejimin e shteteve, të cilat quheshin, konsideroheshin dhe, jo rrallë, ishin armiq të kombit shqiptar. Krahas strukturave të ditura, të njohura, qoftë për publikun, qoftë për kundërzbulimin, ka pasur edhe një strukturë tjetër, e cila varej, në rastet më të shumta, direkt dhe nga askush tjetër veç Enver Hoxhës, dhe e cila, më shumë se gjithçka, kishte lidhje me zbulimin e jashtëm. Nuk janë të pakta rastet, që janë bërë të ditur më vonë, kur vetë Enver Hoxha ka drejtuar lidhje të posaçme dhe ka pasur marrëdhënie të drejtpërdrejta me diplomatë, gazetarë, specialistë, e biznesmenë të huaj, disa prej të cilëve, i kanë sjellë atij informata nga më sekretet.

Është i njohur tashmë fakti se, mes shumë të tjerëve, shërbimi i ngritur dhe i kontrolluar nga EH dhe grupi i veçantë pranë tij, kishte të infiltuar edhe pranë

CIA-s, të cilët kishin role të rëndësishme në operacionet që kryheshin në drejtim të Shqipërisë apo që lidheshin me ngjarjet në pjesët e banuara nga shqiptarët në Jugosllavi. Njeriu i njohur në dosjet e Sigurimit të shtetit shqiptar si "Sali Dani" ishte njëkohësisht edhe një ndër funksionarët më të rëndësishëm të CIA-s. Njëpërmjet tij, diku në mesin e viteve '70, shteti shqiptar kishte arritur të merrte gjithë rrjetin e agjentëve të UDB-së në Shqipëri, por edhe të Asfalisë greke dhe të shërbimit sekret italian. Do të ishte i njëjti agjent, i cili vendosi një lidhje mes EH dhe agjentit të shkallës së lartë, rusit Njekov, i arratisur nga BS, bashkëpunëtor i CIA-s dhe i disa shërbimeve të tjera sekrete, gazetar dhe botues në Romë.

Përse i solla këto pasazhe? Përmes lidhjeve të krijuara me botën agjenturore, lidhje të cilat, e përsëris, kanë qenë shumë të fuqishme, EH kishte një informacion, shpeshherë, më të gjerë se sa vetë strukturat zyrtare të shtetit. Jo rrallë, të dhënat e shçanta ishin vetëm për EH. Është krejt e mundur, që, pikërisht në kohët e para të pasvdekjes së Titos, EH të jetë informuar gjerësisht jo vetëm mbi të zakonshtet, por edhe mbi shumë më tepër se kaq. Si duket, informacioni i tij ka shkuar përtej sferave të zakonshme, dhe lidhjet e tij, jo rrallë, kanë qenë shumë më të thella, se sa ato që mund të dukeshin.

Struktura të tilla kishin lidhje me sfera të larta të shteteve të ndryshme, sidomos ballkanike dhe euroatlantike, ata nuk hynin në veprim për gjëra të vogla dhe me pak vlerë, por për aktivitete të një rëndësie të veçantë, si ishte rasti i gazetarit të njohur ruso-italian Njekov, i cili, çuditërisht, pas realizimit të disa misionëve që kishin lidhje të drejtpërdrejta me EH, u

gjend misteriozisht i vrarë. EH i ruante këto struktura vetëm për linjën e tij, as ministri i punëve të brendshme, shpeshherë, nuk e dinte fillin e tyre dhe nuk kishte lidhje me to.

Njëkohësisht, si është bërë e njohur më vonë se drejtues të ndryshëm të lëvizjeve klandestine në Kosovë, por edhe funksionarë të kohës, kanë pasur lidhje të veçanta me individë të caktuar në Shqipëri. Ata monitoronin nga afër ngjarjet në Kosovë dhe, megjithëse ishin pjesë e Sigurimit të Shtetit, përgjigjeshin direkt në trupën e ngritur nga Enver Hoxha, si ishte rasti i Ajet Haxhiut apo të tjerëve pranë tij.

Si duket, ishin pikërisht këto struktura, jashtë dhe brenda Kosovës, që, duke përdorur lidhjet e dyfishta, në fillimin e vitit 1980, e lajmëruan EH se, ndonëse gjendja në Kosovë në sipërfaqe dukej e qetë, nuk ishte ashtu. Ata e lajmëruan po ashtu se, megjithë heshtjen që zotëronte, shteti jugosllav dhe, sidomos, nacionalizmi serb po përgatitej të lante përfundimisht hesapet me kombet e tjerë në ish Jugosllavi dhe se Kosova do të ishte kurban i parë i madh i kësaj bëme. Ekzistonin të gjitha shenjat se miti i Rankoviçit kërkonte të zgjohej, dhe këtë, jo rrallë, e kishin vërejtur edhe republikat e tjera jugosllave, sidomos kroatët dhe slovenët, të cilët, përmes lidhjeve të tjera, kishin lajmëruar për rrezikun që mund t'i vinte. Kroatëve apo slovenëve nuk do u vinte aspak keq sikur i gjithë tërbimi nacional serb të shkonte drejt shqiptarëve. Ata kishin filluar ta nxisnin këtë tërbim, duke menduar se kështu gjithçka do të rrokullisej drejt viseve shqiptarëve.

Sidoqoftë, unë mendoj se, edhe nëse i ka ditur ngjarjet që mund të vinin, EH nuk ka bërë asgjë për t'i shpejtuar apo për t'i

shmangur lëvizjet e marsit 1981. Të paktën nuk ka bërë asgjë të dukshme, sepse, për atë që për shumë vite ishte e padukshme, ai filloi të bënte. Ndoshta askujt tjetër, më shumë sesa EH, nuk do i kishte interesuar një zhvillim i fuqishëm jashtë kufijve. Kjo do të zhvendoste vëmendjen drejt një caku tjetër shqiptar, përmes të cilit, qaraku i problemeve që kishin lindur në Shqipëri do të hidhej mbi supet e tjetërkujt. Mjeshtër në përdorimin e situatave në dobi të regjimit të tij, ai nuk mund ta linte pas dore këtë rast, që, edhe nëse nuk e kishte përgatitur vetë, e përdori deri në fund.

Sidoqoftë, shumë më vonë, ende i paqartë, por edhe i pa hedhur poshtë, një plan sekrete në lidhje me Kosovën u bë publik nga ish Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.

Fjala është për planin sekret "Shpërthimi", i cili përfshinte një seri operacionesh, në rast të një lufte për Kosovën dhe në Kosovë. Ky plan, që ka qenë tejet sekret dhe për të cilin kanë pasur dijeni fare pak veta, është pëshpëritur për herë të parë, nga agjencitë e huaja, menjëherë pas ngjarjeve të marsit. Pasi është heshtur për shumë vite, plani u shfaq i detajuar, kohët e fundit. "Zgjimim" e planit e bëri njëri ndër hartuesit kryesorë të tij, ish Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë shqiptare, Veli Llakaj. Në një intervistë të gjatë të tij, për herë të parë, ai bëri të njohur originën e këtij plani sekret, hartuesit e tij, urdhrin e dhënë drejtpërsëdrejti nga EH, dhe seriozitetin me të cilin ishte marrë ai plan. Megjithëse sot gjithçka mund të quhet utopi dhe në fakt ka shumë gjëra që nuk do të mund të realizoheshin, ai përsëri ngre disa pika dyshimi. (Vijon)



# Komuna e Gjilanit pranon 80 shtretër dhe pajisje teknologjike

**GJILAN, 21 MARS (ER)** - Komuna e Gjilanit ka pranuar kontingjentin e dytë të shtretërve dhe pajisjeve të tjera, donacion nga bashkatdhetari nga Zvicra, Mehmet Sopa. Nën kryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se ky është donacion jashtëzakonisht i mirëpritur për shkak të qëllimit që ka për kushte më të mira të trajtimit shëndetësor të pacientëve. "Është donacion i bashkatdhetarit tonë Mehmet

Sopa dhe dedikohet për ambulancat e mjekësisë familjare, Spitalin Regional dhe institucionet shëndetësore. Kjo është mbështetje e mirë dhe garanton kushte më të mira të veprimit shëndetësor, sikur që edhe aparatura tjetër është specifike dhe shumë e nevojshme për të dhënë shërbime shëndetësore për pacientët", ka thënë nënkryetari Ismajli. Kurse Arbenita Hajdari, drejtoreshë e QKMF-së, ka pohuar

se donacioni i ardhur sot dhe donacionet që vijnë në institucionet shëndetësore janë mbështetje e madhe për stafin dhe njëkohësisht edhe komoditet më i madh për pacientët. Në emër të donatorit ka folur Refik Ramadani, i cili ka konfirmuar vazhdimin e donacioneve të kësaj natyre, ku janë rreth 80 shtretër, uniforma, rroba të ndryshme, pajisje teknologjike dhe mjete të tjera përcjellëse.



## Lladrovci bën homazhe te varri i dëshmorit Bekim Hysenaj

**Drenas, 21 mars (ER)** - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i shoqëruar nga familjarë dhe bashkëlloftëtarë të

dëshmorit, kanë bërë homazhe pranë varrit të dëshmorit Bekim Hysenaj në varrezat e dëshmorëve në fshatin Abri.

Bekim Hysenaj ra dëshmor më 21 mars të vitit 1999 në betejën frontale të UÇK-së në fshatin Tërstenik.

## Fillon riparimi i ndriçimit publik në Prizren

**PRIZREN, 21 MARS (ER)** - Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) ka njoftuar se pas një periudhe të stërzgatur dyvjeçare të procedurave të prokurimit, që nga fillimi i muajit mars ka filluar riparimi, montimi dhe ndërrimi i trupave ndriçues në Komunën e Prizrenit.

Rregullimi i ndriçimit publik së pari ka filluar nga lagjet që përfshijnë zonën brenda qytetit, siç janë lagjet Bajram Curri, Jeta e Re, Arbana, Dardania dhe Petrova, për të vazhduar më pas në të gjitha fshatrat e komunës së Prizrenit.

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe dyvjeçare janë shfaqur edhe raste, ku ndriçimi publik është dëmtuar qëllimisht nga personat e papërgjegjshëm, ku dhe iu bënë thirrje qytetarëve që ta denoncojnë çdo dëmtim të pronës publike.

Duke i falënderuar qytetarët për durimin dhe mirëkuptimin e treguar, DSHP-ja ka bërë me dije se do të vazhdojë të realizojë edhe projekte të tjera në drejtim të rregullimit dhe instalimit të ndriçimit publik në Komunën e Prizrenit.



## Në Podujevë u përkujtua 31-vjetori i helmimit të mijëra shqiptarëve nga regjimi serb



**PODUJEVË, 21 MARS (ER)** - Përfaqësues të personave të helmuar nga regjimi serb në marsin e vitit 1990 dhe Komuna e Podujevës organizuan një akademi përkujtimore në 31-vjetorin e helmimeve të nxënësve, studentëve, profesorëve, punëtorëve dhe qytetarëve të Podujevës dhe Republikës së Kosovës.

Në këtë akademi të organizuar në përkujtim të kësaj ngjarje tragjike, morën pjesë persona që kishin pësuar nga helmimet, familjarë të tyre,

udhëheqës komunalë, mësime dhe artistë dhe krijues letrarë dhe qytetarë të Podujevës.

Nën kryetarija e Komunës së Podujevës, Marigona Lahu, ka thënë se me dhimbje të madhe kujtojnë të gjithë ata që pësuan nga këto helmime. "Me shpresën se një ditë kryerësit e kësaj veprë kriminale do të përgjigjen para organeve të drejtësisë dhe shteti serb të paditet për krimet e bëra mbi popullatën civile të Kosovës. Helmimet masive të nxënësve nëpër shkolla ku

kryesisht mësonin shqiptarët, filluan në mars dhe vazhduan gjatë gjithë pranverës së vitit 1990. Numri i të prekurve nga helmimi toksik shkoi mbi 7000 e Komuna e Podujevës ishte prej më të prekurave me mbi 1500 të helmuar", ka thënë nënkryetarija Lahu.

Për helmimet e vitit 1990 foli edhe dr. Shyqri Dumani si dhe dy të helmuarit e asaj kohe, profesor Idriz Gashi dhe Lutfi Ismaili, të cilët rrëfyer tmerrin e përjetuar 31 vjet më parë.

## Nis rregullimi i dy rrugëve në Dragobil dhe Banjë të Malishevës

**MALISHEVË, 21 MARS (ER)** - Në kuadër të ndërtimit të rrugëve dhe realizimit të investimeve kapitale në Komunën e Malishevës, këto ditë ka filluar rregullimi i dy rrugëve, njëra

në Dragobil, tjetra në Banjë, rrugë të cilat kanë rëndësi të madhe për lagjet përkatëse. Punimet në këto rrugë i ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së

Malishevës, Hajdin Berisha, i cili është njoftuar nga afër me ecurinë e punimeve si dhe është takuar edhe me banorë të këtyre lagjeve. "Ne jemi duke u munduar që t'i

realizojmë nevojat e qytetarëve për infrastrukturën në përgjithësi, në veçanti për rrugët, pasi kjo është jetike për banorët", ka thënë Berisha.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Ballkani shfrytëzon gabimin e Dritës, merr kryesimin në Superligë

Elita e futbollit e Kosovës vazhdon të bëhet gjithnjë e më interesante. Java e 26-të solli ndeshje të forta, por edhe ndryshim në renditjen tabelore. Ballkani ka përfituar nga gabimi i Dritës dhe është ngritur në vendin e parë



arkëtuar një pikë të rëndësishme në Gjilan, duke barazuar me skuadrën kampione në fuqi dhe kryesuesen e renditjes, Dritën, me shifrat 1-1. Ky barazim ua mundëson dy skuadrave të tjera pretendente për titull që ta zvogëlojnë ngecjen me Dritën. Të parët në epërsi kaluan gjilanasit me golin e shënuar nga Bujar Shabani nga distanca në minutën e 29, por tre minuta para shkuarjes së skuadrave në pushim baraspeshën në rezultat e vendosi Baton Zabërgja, me golin e shënuar nga brendësia e

zonës pas asistimit të Kreshnik Ukës. Ndërkohë, skuadra e fundit në renditje, Besa, e ka befasuar Feronikelin, duke e mposhtur me rezultat 2-1. Të dyja golat për pejanët i shënoi Ardit Tahiri (15', 39'), derisa golin e barazimit të përkohshëm për Feronikelin e shënoi Marko Simonovski. Ndeshja derbi e javës së 26 në Superligën e Kosovës në futboll në mes të Prishtinës dhe Gjilanit është shtyrë. Arsyeja e shtyrjes është që të ruhet fusha në stadiumin "Fadil Vokrri" për

### SUPERLIGA - Java e 27

Trepça - Ballkani	0-2
Llapi - Arbëria	4-3
Drita - Drenica	1-1
Besa - Feronikeli	2-1
Prishtina - Gjilani	(U shty)

### Tabela

	Pikë
1. Ballkani	26 55
2. Drita	26 55
3. Prishtina	25 50
4. Gjilani	25 36
5. Llapi	26 33
6. Trepça '89	26 32
7. Feronikeli	26 31
8. Arbëria	26 27
9. Drenica	26 27
10. Besa	26 10

Në xhiron e radhës takohen: Arbëria-Drita, Feronikeli-Llapi, Drenica-Trepça '89, Gjilani-Besa, Ballkani-Prishtina.

ndeshjet e Përfaqësueses së Kosovës. "Për shkak të ruajtjes së fushës së stadiumit 'Fadil Vokrri', për ndeshjet e Kosovës, ndeshja e javës së 26 ndërmjet Prishtinës dhe Gjilanit është shtyrë për ditën e martë, më 30 mars. Dueli fillon nga ora 15:00", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.

### EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MARS - Java e 26 e Superligës solli ndeshje të forta, por edhe befasitë nuk munguan. Feronikeli është mposhtur nga skuadra e fundit në tabelë, Besa, kurse kampionët e Dritës janë ndalur nga Drenica. Gabimin e klubit gjilanas për mrekulli e shfrytëzoi Ballkani që e ka rrëmbyer pozitën e parë në Superligë, pasi e mposhti Trepçën '89 me rezultat 0-2. Sulmuesi më i mirë për momentin në elitë, Mirlind Daku, e kaloi skuadrën mysafire në epërsi në minutën e 38. Në pjesën e dytë, Ballkani e realizoi edhe golin e dytë dhe të fundit në ndeshje. Në minutën e 69, Arbër Hoxha ishte realizues. Falë

këtyre tri pikëve Ballkani ngritët në pozitën e parë me 55 pikë, aq sa ka edhe Drita në vendin e dytë. Trepça '89 është e gjashta me 32 pikë. Fitores të dielën i është gëzuar edhe Llapi në përballje me Arbërinë. Skuadra e drejtuar nga Tahir Batatina triumfoi me rezultat 4-3. Pjesa e parë u mbyll 2-1, Kreshnik Bahtiri shënoi dy autogola, kurse për mysafirët shënoi Marclei. Në pjesën e dytë të dyja skuadrat i shënuan nga dy gola. Për Llapi realizues ishin Hyseni dhe Januzi. Për mysafirët shënuan Marclei dhe Zabërgja. Llapi me tri pikët e reja ngritët në kuotën e 33 pikëve dhe zë vendin e pestë, kurse Arbëria mbetet në kuotën e 27 pikëve në vendin e tetë. Skuadra që po lufton për mbijetesë në elitë, Drenica, ka

## Reja: Të lejohen tifozët në ndeshjet e marsit

TIRANË, 21 MARS - Pritja ka marrë fund dhe trajneri i Kombëtares Shqiptare, Edoardo Reja, ka publikuar listën me 28 futbollistët që ka ftuar t'i përgjigjen grumbullimit për tri ndeshjet eliminatorë të Kupës së Botës Katar 2022. Nuk mungojnë risitë në listën e publikuar nga tekniku italian, teksa është konfirmuar grumbullimi për herë të parë i fantazistit të Empolit, Nedim Bajrami. "Ka disa emra të rinj, për shembull Nedim Bajrami, i cili po paraqitet mjaft mirë tek Empoli dhe për herë të parë i bashkohet grupit. Me të i kemi nisur kontaktet prej një viti dhe shpresoj të jetë një vlerë e shtuar për Shqipërinë. Kemi thirrur, gjithashtu, edhe Mario Mitajn, i cili po spikat tek AEK-u në kampionatin grek dhe e kemi marrë të ambientohet, pasi është ende shumë i ri dhe e shohim si pjesë të rëndësishme për të ardhmen. Më pas kemi Çokajn, Kallakun, të gjithë lojtarë të ekipit Kombëtar U-21 dhe, gjithashtu, Kamberi, të cilin nuk e kemi pasur në dispozicion më parë për arsye të ndryshme, por mendoj se ka ardhur momenti i duhur që, më

në fund, mund ta shohim në aksion me ne", u shpreh trajneri. Bekim Balaj dhe Armando Sadiku janë dy nga emrat e mëdhenj të kuqezinjve të lënë jashtë këtij grumbullimi, por është rikthyer pas disa kohësh Arlind Ajeti. "Ajeti po bën mjaft mirë në klubin e tij në Itali, ku po luan titullar dhe është në formë optimale, ndaj e kemi thirrur për ta zëvendësuar Dermakun, që ka qenë i dëmtuar prej muajsh. Më vjen keq që nuk kam thirrur lojtarë si Bekim Balaj, që kanë dhënë shumë për skuadrën, por më është dashur të krijoh hapësira për më të rinjtë që po luajnë rregullisht. Kemi grumbulluar vetëm 28 lojtarë. Lista jonë prioritare është me 38-40 futbollistë që i kemi vazhdimisht në vëmendje", ka shtuar Reja. Tekniku kuqezi shprehet se është mjaft i kënaqur me aktivizimin dhe formën e lojtarëve që ka grumbulluar për këto ndeshje eliminatorë, teksa bën thirrje që të gjithë ta ruajnë përqendrimin maksimal për ndeshjen me Andorrën. "Që pas përfundimit të merkatos së



janarit, thuajse të gjithë futbollistët e grumbulluar kanë luajtur rregullisht dhe çdo tri ditë, ndaj jam i bindur që vijnë në një formë fizike mjaft të mirë. Duhet ta ruajmë përqendrimin veçanërisht ndaj një kundërshtari si Andorra, pasi kemi gabuar edhe më herët ndaj tyre. Në këto eliminatorë dua ta shoh rritjen e ekipit, pasi tani lojtarët e njohin më mirë

njëri-tjetrin dhe kanë fituar më shumë përvojë edhe me klubet, ndaj besoj te një performancë e mirë edhe me kundërshtarë si Hungaria e Polonia", u shpreh Reja. Së fundi FShF-ja bëri edhe një përpjekje zyrtare për të marrë leje për praninë e tifozëve në stadium për ndeshjen me Anglinë, por mori përgjigje negative nga autoritetet

shëndetësore, ndërsa vetë Reja theksoi se fansat kuqezi në shkallët e "Air Albanias" do të ishin një bonus për futbollistët në fushë. "Është një kërkesë e drejtë ajo e FShF-së, pasi me 30 % të kapacitetit është e mundur të ruhet edhe distanca fizike. E imagjinoni nëse do të kishte disa tifozë në një ndeshje me Anglinë dhe kënaqësinë e madhe që do të kishin futbollistët që, më në fund, do të shohin pak spektatorë në tribuna, të cilët do të kritikonin, do t'i motivonin, për të marrë pjesë në ndeshje, sepse futbollit pa publik nuk mund të ekzistojë. Shpresoj të bëhet i mundur ky lëshim, pasi do të ishte një rezultat i shkëlqyer", u shpreh trajneri italian i kuqezinjve. Rugëtimi i kuqezinjve në këto eliminatorë do të nisë nga Barcelona, një qytet shumë afër gjeografikisht me Andorrën, aty ku kuqezinjët do të bëjnë edhe performancën e parë zyrtare më 25 mars, teksa vetëm tri ditë më vonë do të përballen me Anglinë në "Air Albania" e më pas do të luajnë sërish në transfertë, këtë herë ndaj San Marinos më 31 mars.

## Kosova me dy humbje mbylli kualifikueset për Botëror

Prishtinë, 21 mars - Hendbollistet e Kosovës e kanë humbur me rezultat të ngushtë ndeshjen e dytë në kuadër të fazës së parë kualifikuese për Botërorin e këtij viti. Pas humbjes nga Austria (26:20) të premtën,

Kosova u mposht edhe nga Italia të shtunën me rezultatin 24:22. Pjesa e parë e këtij takimi të luajtur në Austri është mbyllur me shifrat 11:19 në të mirë të italianeve. Ilaria Dalla Costa e Bianca Dal Bazo ishin më

të dalluarat tek Italia, me nga pesë gola të shënuara derisa Giada Babbo shtoi katër. Te Kosova u veçua Elma Kameri me gjashtë gola të shënuara, e përcjell nga Marigona Hajdari me pesë sosh. Italia dhe Austria kanë nga një

fitore në grup dhe të dielën do të përballen për pozitën e parë. Ndërsa Kosova, që pati mungesa të theksuara, e mbylli këtë fazë me dy humbje në po aq ndeshje të luajtura duke përfunduar e fundit në grup.



## Lala: Kjo është e vërteta për mostransferimin e Rashicës në Milan

TIRANË, 21 MARS - Ish-kapiteni i Kombëtares Shqiptare dhe menaxheri i Milot Rashicës, Altin Lala, ka treguar se klienti i tij ishte afër kalimit të kekipi i Milanit verën e shkuar. Ai në emisionin "Zona Gol" foli për eliminatoret e Kupës së Botës, talente të kuqezinjve si Broja e Çepele, por zbuloi edhe një prapaskenë me sulmuesin e Kosovës, Milot Rashica. "Miloti tani ka arritur njëfarë niveli, shumë skuadra e kanë ndjekur dhe kanë dashur ta marrin, por ky vit ka qenë problematik për shkak të Covidit dhe Werder Bremenin. Në verë me shumë gjasë do të kemi një transferim të Rashica. Gjasat ishin të mëdha që në qoftë se do të bëhej Ralf Rangnik trajner i Milanit dhe Milot Rashica do të



kalonte te kuqezinjët, por ajo nuk ndodhi", ka thënë Lala. Më tutje, ai analizoi edhe gjasat e Shqipërisë në eliminatoret për Kampionatin Botëror. "Unë mendoj se gjithmonë kualifikueset për Kampionatin Botëror janë

gjithmonë të forta. Duhet të kemi qëllim të dalim përpara Hungarisë dhe ta sulmojmë Poloninë. Kemi grup lojtarësh të mirë dhe trajnerë me përvojë. Gjasat janë të mëdha që të zhvillojmë një edicion të mirë", ka shtuar Lala.

## Lakersat pësojnë humbje nga Atlanta, lëndohet LeBron

LOS ANGELES, 21 MARS - Los Angeles Lakersi vijon të shfaqet me luhajtje dhe tashmë ka dorëzuar edhe vendin e dytë të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Skuadra kaliforniane është mposhtur në shtëpi nga Atlanta Hawksi me shifrat 94-99, por humbja më e madhe ka qenë dëmtimi i liderit të ekipit, LeBron James. Ky i fundit luajti pak më tepër se çerekun e ndeshjes për t'u shtrirë më pas në parket, pasi nuk mund të vijonte më ndeshjen, teksa gjatë ditës së sotme pritet të përcaktohet se kur do të rikthehet sërish të kontribuojë për Lakersat. Sa i përket sfidës, gjithçka ishte e balancuar pas gjysmës së parë, por në fraksionin e tretë u prishën ekuilibrat, pasi Hawksi triumfoi me shifrat 12-22 falë formës së mirë të Collinsit e italianit Gallinari, ndërsa më pas ruajtën avantazhin deri në gongun final. Disa orë më vonë, po në "Staples Center", skuadra tjetër e Los



Angelesit, Clippersat, ia doli të fitojë me shifrat 125-98 ndaj Charlotte Hornetsit. Paul George dhe Kawhi Leonard ishin protagonistët e Clippersave në sfidën ndaj Hornetsit, duke shënuar së bashku 38 pikë, rikuperuar 8 topa dhe dhënë 13 asistime. Philadelphia 76ers vijon të kryesojë në Konferencën e Lindjes dhe pas humbjes dy ditë më parë ndaj Milwaukee Bucksit, ka reaguar mbrëmjen e djeshme duke triumfuar me shifrat 129-

105 ndaj Sacramento Kingsit. Harris dhe Milioni ishin protagonistët absolutë të suksesit të 76ers, të cilët zgjodhën gjithçka që në fraksionin e parë, duke vendosur një avantazh të konsiderueshëm, të cilin e menaxhuan mirë deri në fund të takimit. Në sfidat e tjera, Memphis Grizzliesi triumfoi me shifrat 111-103 ndaj Golden State Warriorsit, ndërsa Milwaukee Bucksit fitoi me rezultatin 120-113 ndaj San Antonio Spursit.

### SHKURT

#### Bayerni kryeson renditjen e UEFA-s

Pas luajtjes së raundit të 1/8-ave të Ligës së Kampionëve dhe Ligës së Evropës, është përditësuar edhe renditja e fundit e klubeve. Kryeson gjithnjë fituesi i Ligës së Kampionëve në fuqi, Bayern Munchen, i ndjekur nga gjigantët spanjollë të Realit dhe Barcelonës. Juventus, skuadra e parë italiane, ka humbur një pozicion dhe zbrit nga podi përsëri pas eliminimit nga Porto. Në vend të pestë renditet Atletico e Madridit, që ka zbritur një pozicion pas eliminimit nga Chelsea. Dhjetë vendet e para kompletohen nga Manchester City, PSG, Manchester United, Liverpools dhe Sevilla. Arsenali, Borussia Dortmund, Chelsea, Tottenhami, Porto, Roma, Ajaxsi, Shaktari, Lyon dhe Napoli kompletojnë top njëzetëshen.

#### RB Leipzig transferon talentin Simakan

Talenti i Strasbourgut, Mohamed Simakan, është transferimi më i ri i RB Leipzig. Klubi gjerman, pas Brobbery i cili erdhi nga Ajaxi, radhën e ka Mohamed Simakan nga Strasbourg. Simakan u kërkua me ngulm nga Milani, por tentativa e "Rossonerëve" dështoi. Tani, sipas gazetarit italian Fabrizio Romano, Simakan tek RB Leipzig tashmë është punë e kryer. Romano raporton se francezi ka përfunduar testimet mjekësore dhe pritet që në ditët në vijim marrëveshja të bëhet zyrtare.

#### Solskjaer kërkon që Cavani mos të largohet

Trajneri i Manchestrit Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, është rikthyer të flasë për të ardhmen e Edinson Cavanit. Trajneri Solskjaer ka thënë se klubi e dëshiron sulmuesin veteran në ekip, por në fund do të jetë ai që do të vendosë. "Ne po flasim me Eddyn. Ai është një sulmues i niveleve të larta dhe mbetet për t'u parë se çfarë do të vendosë. Bisedimet me të po shkojnë shumë mirë. Ne duam një ekip sa më kompetitiv dhe kemi nevojë për dikë në sulm që të shënojë gola. Kështu që po përpiqemi që ai të rinovojë me ne", ka deklaruar Solskjaer.

#### Ancelotti: City është skuadra më e mirë në botë

Trajneri i Evertonit, Carlo Ancelotti, ka thënë se nuk është i dëshpëruar me humbjen e ekipit të tij nga Manchester City, pasi City është skuadra më e mirë në botë. "Ne ishim pothuajse atje, bëmë mirë dhe bëmë më të mirën që mund të bënim. Mbrojtëm mirë dhe për të paktën 80 minuta, kishim ndeshjen nën kontroll. Unë jam i kënaqur sepse ne u mundëm nga ekipi më i mirë në botë - ata janë më të mirët", ka thënë Ancelotti. "Ata kanë stolin më të mirë në botë. Ishte një përvojë e mirë për ne dhe nuk ka keqardhje. Keqardhjet janë ndeshjet kundër Burnleyt ose ndeshja kundër Fulhamit, por ne jemi në kohë. Kemi 10 ndeshje në kampionat dhe duam të luftojmë për pozicionin tonë në Evropë sezonin e ardhshëm", ka shtuar Ancelotti.

## Lojërat Olimpike do të mbahen pa publik të huaj

Në Lojërat Olimpike në Tokio nuk do të lejohen spektatorët nga jashtë. Vendimi u njoftua pas një takimi të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, qeverisë japoneze, Qeverisë së Tokios, Komitetit Paraolimpik

Ndërkombëtar dhe organizatorëve lokalë. "Ne shprehim zhgënjimin e të gjithë tifozëve entuziastë të Olimpiadës nga e gjithë bota, dhe natyrisht familjeve dhe miqve të atletëve, të cilët po planifikojnë të vinin në

Japoni", ka thënë presidenti i IOC-së, Thomas Bach. Lojërat Olimpike Tokio 2020 ishte paraparë të mbahen vitin e kaluar, mirëpo ato u shtynë për shkak të pandemisë. Hapja e tyre do të bëhet më 23 korrik. Komiteti

do t'i rimbursojë tifozët jashtë shtetit që kanë blerë tashmë bileta. Deri më tani janë shitur 630.000 bileta, sipas shefit ekzekutiv të komitetit Toshiro Muto. Vendimi për ta ndaluar pjesëmarrjen e publikut të huaj

merret për shkak të frikës nga një rritje e numrit të të infektuarve në Japoni. Japonia ka njoftuar për rreth 8.800 vdekje nga Covid-19 dhe ka kontrolluar përhapjen e virusit më mirë se shumica e vendeve.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë





KOMPANIA REGJONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA  
**K.R.M. "ÇABRATI"**

Tel.+381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nën 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212), nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.7/2017, dhe Vendimin Nr. 19/2021 me Nr. Protokolli 467 i datës 19.03.2021, në përputhje edhe me Organogram dhe Rregulloren "Për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Përgjegjësitë në Punë", Nenit 5 të "Rregullores Për Pagat" si dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrje Publike në fuqi, nenit 25 të Statutit të K.R.M. "Çabrati" Sh.A, Gjakovë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 19.03.2021, vendosi që me datën 22.03.2021 të shpallë:

## KONKURS

**Pozita:** Certifikues i/e Pagesave,  
**Numri:** 1 /një/  
**I përgjigjet:** Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Thesarit.  
**Vendi:** Gjakovë.

### Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Mbikëqyrë dhe koordinon aktivitetet e pagesave, të buxhetit, shpenzimeve, prokurimit, dhe aktivitetet operative që sektorët e kompanisë i realizojnë gjatë aktivitetet operative të menaxhimit;
- Vlerëson efektivitetin e punës dhe zbatueshmërinë konform me procedurat dhe rregullat në kompani;
- Është përgjegjës për certifikimin e pagesave të ndryshme për aktivitetet operative të kompanisë;
- Aplikon sistemin e kontrollit të rrjedhës së dokumentacionit prej fillimit të kërkesës për kategori të caktuara të shpenzimeve si dhe bën aprovimin e këtyre pagesave me anë të nënshkrimit;
- Siguron që sistemi i pagesave të jetë në harmoni me rregullat ligjore dhe urdhëresat nga menaxhmenti;
- Mbikëqyrë dhe kontrollon secilin dokument për ekzekutimin e pagesave si dhe a janë në përputhje me rregulloret e operimit që mbulojnë sektorët në rastet e ekzekutimit të pagesave;
- Në raste të mos kompletimit të dokumentacionit në urdhërpagesa duhet të informojë Udhëheqësin e Financave dhe Thesarit për dokumentacionin që mungon për urdhërpagesë;
- Analizon praktikat dhe procedurat e sistemit të pagesave si dhe propozon modifikimin apo përshtatjen e tyre sipas standardeve të kontabilitetit në vend;
- Mbanë evidencën në formë elektronike mbi faturat e certifikuar dhe prezanton shënime të sakta kur ato kërkohen;
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga Udhëheqësi.

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë përgatitje superiore-Fakulteti ekonomik, 4 vjeçare ose me sistem Bolonjës 3+2;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë në sektorin e pagesave;

#### Kushtet e veçanta:

- Njohja e punës me kompjuter,
- Njohja e regjistrimeve kontabile,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi, dhe
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

#### Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Dëshmia se e njej punën me kompjuter,
- Dëshmia se ka njohuri me regjistrime kontabile-Referenca
- Dëshmia se njej gjuhë të huaja,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Konkursi është i hapur 15 ( pesëmbëdhjetë) ditë, nga data 22.03.2021 deri me datën 06.04 2021, në orën 16:00.

Kërkesa me dokumentacionin e kërkuar, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazlom Lakuci" pn. (tek menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sale Elezovic shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Planjane " Planjane.

► Fikri Hoxhaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Fahro Veliji shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Planjane " Planjane.

► Fahro Veliji shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Vlora Milazim Imeri shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë me nr. 31, Bachelor i Gjeologjisë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

